REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER RIDVANA G. RUÇI
ADRESA KAJO KARAFILI
TEL: 683030361

# KONTRATË DHURIMI PASURI E LUAJTSHME

(AKSIONE)

**Nr. repertori: 8347** **Nr. koleksioni: 3533**

**Tirane më 30/12/2021**

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

A2021053240360136820

A2021053240360136820

# KONTRATË DHURIMI KUOTASH KAPITALI

Sot, më datë 30/12/2021, para meje Notere RIDVANA G. RUÇI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, KAJO KARAFILI, u paraqit personalisht:

**DHURUES:**Ardjan Çelaj, atësia Petrit, amësia Nekie, shtetas Shqiptar, lindur në Ballsh, Fier dhe banues në Tiranë, me adresë Ibrahim Kodra; Nd. Nd.4; H. 2; Ap. 3; Njësia Administrative Nr. 5; Njesia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 20/09/1972, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 032728379 dhe nr. personal H20920074K, *(Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si "**Dhururesi**")*

**PRANUES I DHURIMIT:**Elton Muço, atësia Elmaz, amësia Vito, shtetas Shqiptar, lindur në Gjirokastër dhe banues në Tiranë, me adresë S.Petrela; Nd. 0; H. 0; Ap. 0; Njësia Administrative Nr. 3; Tiranë; 0000; Tiranë, lindur më 27/08/1979, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035016517 dhe nr. personal H90827065E, *(Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si "**Përfituesi i dhurimit**")*

**Baza Ligjore**

I Neni 761 e vijues të Kodit Civil

a- Neni 73, pika 1, gërma "ç" (për kuotat e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar ose neni 117, pika 1, gërma "ç" (për aksionet e shoqërive aksionare/anonime) të Ligjit nr. 9901, datë 14.08.2009 *"Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"*, i ndryshuar

I. Neni 62, gërma "ll", neni 63, pika 1, gërma "ç", si dhe nenet 99, 100, 101 e vijues të Ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018 *"Për Noterinë"*

**DEKLARATA PARAPRAKE:**

**Neni 1**

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar **Shoqeria** A&A COMPANY shpk, rregjistruar prane QKB me NIPT L71413018H , me seli ne Tirane, Lagjja nr 5, Rruga Berisha, Zona Kadastrale 2066, Nr Pasurie 130/180, perfaqesuar nga ortaku i vetem i shoqerise ("**Shoqeria**").

Dhuruesi **Ardjan Çelaj** zotëron 100 % të kapitalit të shoqërisë A&A COMPANY shpk (këtu e mëposhtë referuar si "**Shoqëria**"). Ne cilesine e Ortakut te vetem te shoqerise permes vendimit te dates 30.12.2021 ka shprehur pelqimin: per dhurimin ne masen 100% te kapitalit te shoqerise nga dhuruesi tek pranuesi i dhurimit Elton Muço.

1.1 Me anë të kësaj kontrate Dhuruesi **Ardjan Çelaj** i transferon Pranuesit **Elton Muço** me anë të dhurimi 100 % të kapitalit te zoteruar në Shoqërinë A&A COMPANY shpk.

1.2 Pranuesi deklaron se pranon dhurimin e 100% te kapitalit te shoqerise A&A COMPANY shpk .

1.3 Nepermjet transferimit me ane te dhurimit, kapitali themeltar i shoqërisë) zoterohet ne kete menyre:

b- Ortaku **Elton Muço** eshte zoterues i 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

1.4 Transferimi i ketij dhurimi do të kryhet në përputhje me legjislacionin shqipëtar në fuqi dhe më veçanërisht me dispozitat e Kodit Civil dhe Ligjit Nr. 9901/2008 të ndryshuar, *"Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"* me ndryshimet perkatese.

II. Ne baze te Statutit te Shoqerise ("**Statuti**") kuotat mund te transferohen lirisht mes ortakeve dhe asnjeri prej ortakeve te Shoqerise nuk ka ndonje kundershtim ne lidhje me kete.

Palet bien dakord per nenshkrimin e kesaj kontrate per dhurimin e kuotave nepermjet Shitesit dhe Bleresit ("**Kontrata per Dhurimin e Kuotes**" ose "**Kontrata**"), si me poshte vijon:

**Neni 2**

A2021053240360136820

## Objekti i Kontrates

2.1 Ne daten e nenshkrimit te kesaj Kontrate (**"Data e Nenshkrimit"**), Dhuruesi i dhuron pranuesit te dhurimit Kuotat te lire nga cdo Barre.

2.2 Kuota e dhuruar do te transferohen juridikisht nga pronesia e dhuruesit ne pronesi te pranuesit te dhurimit dhe pala pranuese do te behet zoterues ligjor i gjithe kuotes menjehere pas rregjistrimit te kesaj kontrate prane QKB-se.

## Neni 3
## Deklarimet dhe Garancite e Shitesit

3.1 Dhuruesi deklaron dhe garanton ne lidhje me transferimin qe parashikohet ne kete Kontrate, per te gjitha ceshtjet qe vijojne.

3.1.1 *Autorizimi* – Te gjitha veprimet, aktet dhe / ose procedurat e tjera te parashikuara nga legjislacioni shqiptar dhe / ose aktet e Shoqerise qe duhet te ndermerren nga ose per llogari te Dhuruesit dhe qe autorizojne Dhuruesin te lidhe dhe te zbatoje kete Kontrate jane kryer rregullisht. Kjo Kontrate eshte nenshkruar dhe dorezuar rregullisht nga Dhuruesi dhe perben nje detyrim te vlefshem dhe ekzekutiv per Dhuruesin dhe qe duhet zbatuar prej tij, ne perputhje me kushtet dhe afatet e Kontrates.

3.1.2 *Nenshkrimi* – Nenshkrimi i kesaj Kontrate nuk kerkon asnje depozitim, miratim, autorizim te cfaredolloji nga ndonje autoritet shteteror ose pale e trete.

3.1.3 *Pronesia* – Dhuruesi eshte pronar i ligjshem i Kuotave . Kuota eshte percaktuar dhe emetuar rregullisht si dhe jane shlyer plotesisht nepermjet kontributit ne para ne kapitalin themeltar te Shoqerise.

3.1.4 *Kuotat* - Kuotat jane te lira dhe te cliruara nga cdo Barre e cfaredo lloji dhe dhuruesi ka te gjitha te drejtat, kompetencen dhe autorizimin e plote per t'i dhuruar , per t'i kaluar, transferuar dhe dorezuar Kuotat ne perputhje me afatet e kasaj Kontrate. Nuk ka asnje kontrate, marreveshje ose detyrim qe krijon ose vendos ndonje Barre ne lidhje me Kuotat ose ndonje numer Kuotash te autorizuara por te paemetuara ne kapitalin e Shoqerise. Asnje person nuk pretendon se ka ndonje te drejte mbi ndonje Barre lidhur me ndonje nga Kuotat. Pervec kesaj Kontrate, nuk ka asnje kontrate, marreveshje, ose detyrim qe parashikon dhenien, emetimin, transferimin, riblerjen ose ripagimin ose dhenien e se drejtes nje personi, te drejten e parablerjes apo te kembimit, ne lidhje me Kuotat objekt te kesaj kontrate.

## Neni 4
## Ligji i zbatueshem dhe juridiksioni kompetent

4.1 Kjo Kontrate rregullohet nga ligji Shqiptar.

4.2 Cdo konflikt ne lidhje me lidhjen, interpretimin, zbatimin, zgjidhjen, perfundimin e Kontrates do te zgjidhet nga juridiksioni kompetent gjyqesor shqiptar.

## Neni 5
## Te ndryshme

5.1 Cdo shtese, ndryshim, zgjidhje ose heqje dore nga ndonje prej dispozitave te kesaj Kontrate, do te jete e vlefshme vetem nese behet me shkrim, me akt noterial dhe nenshkruhet nga ose ne emer te secilës Pale.

5.2 Ne rast se nje dispozite ose detyrim sipas kesaj Kontrate eshte i pavlefshem, i paligjshem ose i pazbatueshem ne nje juridiksion, vlefshmeria, ligjshmeria dhe zbatueshmeria e dispozitave ose detyrimeve te tjera, ose e ketyre dispozitave ose detyrimeve ne nje juridiksion tjeter, nuk do te preket nga nje fakt i tille.

5.3 Palet do te perpiqen te zevendesojne nje dispozite te pazbatueshme ose te pavlefshme, ne masen me te madhe te mundshme, per te arritur qellimin e kesaj dispozite.

5.4 Kjo Kontrate nenshkruhet ne 4 (kater) kopje origjinale.

5.5 Asnjera Pale nuk mund te kaloje dhe / ose te transferoje te drejtat dhe / ose detyrimet sipas kesaj Kontrate, ne teresi ose ne vecanti, pa miratimin paraprak me shkrim te Pales tjeter.

5.6. Pervec kur parashikohet ndryshe ne kete Kontrate, secila Pale do te paguaje shpenzimet e saj ne lidhje me negocimin, hartimin, nenshkrimin e kesaj Kontrate dhe shtojcave te saj.

A2021053240360136820

Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve kontraktuese nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj Kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**DHURUES**

**Ardjan Çelaj**

**PRANUES DHURIMI**

**Elton Muço**

**NOTER**

**RIDVANA G. RUÇI**

# VENDIM

**Nr. 3 Date 30/12/21**

Vendim i Ortakeve te Shoqërisë " A&A COMPANY shpk," sh p k

Ne mbledhjen e ortakut te vetem te shoqerise te datës 30/12/21..., ne te cilën pas verifikimit te pjesëmarrjes, ortaku i Shoqërisë vendosi te marri këtë vendim. Me këtë vendim qe ka vlere ligjore, i Ortakeve te Shoqërisë A&A COMPANY shpk, sh.p.k rregjistruar prane QKB-se me NIPT L71413018H, me seli ne Tirane Lagjja nr 5, Rruga Berisha, Zona Kadastrale 2066, Nr Pasurie 130/180.

-Ardjan Çelaj, atësia Petrit, amësia Nekie, shtetas Shqiptar, lindur në Ballsh, Fier dhe banues në Tiranë, me adresë Ibrahim Kodra; Nd. Nd.4; H. 2; Ap. 3; Njësia Administrative Nr. 5; Njesia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 20/09/1972, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtes i leternjoftimit me Leternjoftim ID nr. 032728379 dhe nr. personal H20920074K, .

Me rendin e ditës:

1. Miratimin e dhurimit te 100% te kapitalit te Shoqërisë " A&A COMPANY" shpk qe zotërohen respektivisht nga Ortaku i vetem i kesaj Shoqërie respektivisht Ardjan Çelaj ne masen prej 100 % ne drejtim te Elton Muço
2. Përfaqësimi i shoqërisë nga Administratori Ardjan Çelaj ne vijimësi.

Ortaket e Shoqërisë janë si me poshtë:

a. Ortaku z. Ardjan Çelaj eshte zotërues i 100 % te kapitalit te shoqërisë

Duke qene se:

Shoqëria A&A COMPANY sh.p.k është shoqëri shqiptare me Përgjegjësi te kufizuar ne seli ne Tirane TIRANE Lagjja nr 5, Rruga Berisha, Zona Kadastrale 2066, Nr Pasurie 130/180, e regjistruar me nr NIPT L71413018H, ortaku i kësaj shoqërie vendos unanimisht qe:

1. Ortaku i Shoqërisë dhe kuota e zotëruar do te jene ne vijim si vijon:
   a. Ortaku Elton Muço pas dhurimit te bere do te jete zotërues i 100% te kapitalit themeltar te Shoqërisë
2. Vendoset qe përfaqësimi i Shoqërisë te vijoje te kryhet nga Administratori Ardjan Çelaj

PER KETO ARSYE U VENDOS:

1. Te miratohet transferimi i pronësisë me anë të dhurimit te 100 % te kapitalit themeltar nga Ortaku Ardjan Çelaj tek Z. Elton Muço ne përputhje me kontratën respektive bashkëlidhur këtij Vendimi
2. Përfaqësimi i Shoqërisë te vazhdoje te kryhet nga Administratori Ardjan Çelaj

**Ortaku i Shoqërisë**
**Ardjan Çelaj**

Ardjan Çelaj